

Isak Behluli lider i fshatit Pasjak

E martë, 14 Maj 2013 12:03



Novobërdë - (2LONLINE) - Zyrtarë komunal kanë bërë të ditur se është bërë zgjedhja e këshillave lokale dhe liderit për fshatin Pasjak

Në këtë takim morën pjesë Kryetari i Komunës Bajrush Ymeri, Komisioni i përzgjedhur nga kuvendi komunal, përfaqësues nga Projekti Zvicër-Kosovë për qeverisje dhe decentralizim LOGOS si dhe qytetarë të interesuar.

Hapjen e takimit e bëri Skender Avdyli i cili fillimisht falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen dhe gatishmërinë e tyre dhe vazhdoi me pikat e rendit të ditës, propozimi i kandidatëve për anëtarë të këshillit të fshatit .

Pas votimit anëtarë të këshillit të fshatit u zgjodhën Isak Behluli, Miftar Osmani, Jashar Ahmeti, Nijazi Shemsedini, Naim Ahmeti, Avdil Zeqiri dhe Hajdin Behluli.

Pas votimit kandidati i votuar për lider të fshatit Pasjak u zgjodh Isak Behluli i falënderoi bashkëfshatarët për besimin e dhënë dhe premtoi që do të punojnë së bashku me bashkëfshatarët për të mirën e këtij fshati.